



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Ekonomisë dhe Financave - Ministarstvo Privrede i Finansija -
Ministry of Economy and Finance

Administrata Tatimore e Kosoves - Poreska Administracija Kosova - Tax
Administration of Kosovo

UDHËZIMIN ADMINISTRATIV NR. 08 / 2010
PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 03/L-162, PËR TATIMIN NË TË
ARDHURAT E KORPORATAVE

Ministria e Ekonomisë dhe Financave

Mbështetur në nenin 39 të Ligjit Nr. 03/L-162, "Për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave," Ministri i Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave,

nxjerr:

UDHËZIMIN ADMINISTRATIV
PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 03/L-162, PËR TATIMIN NË TË ARDHURAT
E KORPORATAVE

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është vendosja e procedurave dhe kërkesave për zbatimin e dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-162, "Për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave", (këtu e tutje e referuar si Ligji).

Neni 2
Përkufizimet

1. Paragrafi 1.3 i nenit 2 të Ligjit e definojnë "**Dividentën**" si shpërndarje të bërë nga kompania për aksionarët. Pavarësisht se a është shpërndarja një dividendë ajo duhet të bazohet vetëm në përkufizimin e dhënë në Ligj pa marrë parasysh nëse entiteti ka fituar apo jo fitime gjatë periudhave tatimore aktuale ose të mëparshme.
2. Paragrafi 1.13 i nenit 2 të Ligjit e definojnë "**Rezidentin**" si "një person apo grup personash që është themeluar në Kosovë ose që ka vendin e vet të menaxhimit efektiv në Kosovë".

2.1 Kërkesa për të qenë **"I vendosur"** në Kosovë nënkupton entitetin qoftë një organizatë biznesi ose një organizatë jo-fitimprurëse ose një organ qeveritar etj, është themeluar sipas ligjit të Kosovës dhe e regjistruar nga autoritetet përkatëse kompetente në Kosovë.

2.2 Termi **"Vendi i Menaxhimit Efektiv"** nënkupton vendin ku mblihdhen shumica e drejtorëve ekzekutiv dhe udhëheqin punën në operacionet e përditshme. Kjo nuk e nënkupton domosdoshmërisht drejtorin e entitetit.

Neni 3 **Të Ardhurat e Tatueshme**

1. Paragrafi 1 i nenit 5 të Ligjit parashikon që *"Të ardhurat e tatueshme për një periudhë tatimore nënkuptojnë dallimin ndërmjet të ardhurave bruto të pranuar ose të përlllogaritur gjatë periudhës tatimore dhe zbritjet dhe shtesat e lejuara sipas këtij ligji në lidhje me të ardhurat e tilla bruto"*. Në lidhje me të ardhurat bruto në vijim, të tjera nga të ardhurat bruto nga kontratat afat gjate ndërtimore dhe projektet, shprehja *'që janë marrë ose përlllogaritur'* do të ketë kuptimin e mëposhtëm:

2. *Aktiviteti i Biznesit. "Pranuar"* nënkupton të ardhurat që janë pranuar në periudhën tatimore kur janë furnizuar mallrat ose kur janë kryer shërbimet. Për bizneset që i nënshtrohen tatimit të paragjykuar, metoda e kontabilitetit do të jetë ajo me para të gatshme, kështu që të ardhurat do të raportohen në periudhën tatimore kur janë pranuar parat. Për bizneset që i nënshtrohen tatuarjes në të ardhurat reale metoda e kontabilitetit do të jetë metodë akruale kështu që të ardhurat do të raportohen në periudhën tatimore kur janë furnizuar mallrat dhe kur janë kryer shërbimet, kur është lëshuar fatura ose janë pranuar parat, cilado që të ndodhë e para.

3. *Qiratë. "Pranuar"* dhe *"Akruale"* kanë të njëjtin kuptim për qëllime të këtij Udhëzimi Administrativ. Të ardhurat nga qiraja nga lëshimi me qira i pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme do të raportohen në periudhën tatimore në të cilën janë furnizuar shërbimet e qirasë, është lëshuar fatura ose janë pranuar parat, cilado që të ndodh e para.

4. *Shfrytëzimi i pasurisë së paprekshme. "Pranuar"* dhe *"Akruale"* kanë të njëjtin kuptim për qëllime të këtij Udhëzimi Administrativ. Të ardhurat nga patentat, të drejtat e autorit, markat tregtare, ekskluzivitetet etj, do të raportohen në periudhën tatimore në të cilën janë pranuar të ardhurat nga përdorimi i pasurisë së paprekshme.

5. *Interesi.* Të ardhurat nga interesi do të raportohen në periudhën tatimore në të cilën ky interes është paguar apo kredituar në llogarinë e pranuesit.

Shembull:

Personi juridik investon fonde në bankë me afatizim për gjashtë muaj. Interesi i shtohet bilancit të depozitit të afatizuar për çdo muaj. Në fund të periudhës prej gjashtë muajsh, personi juridik vendos që ti mbaj fondet në depozit të afatizuar për gjashtë muaj të tjera. Interesi i kredituar në bilancin e llogarisë për çdo muaj do të përfshihet në të ardhurat bruto në muajin në të cilin është kredituar. Trajtimi tatimor mbetet i njëjtë pavarësisht se a është tërhequr interesi apo jo në çdo muaj, dhe pavarësisht se a janë tërhequr fondet nga afatizimi dhe janë ri-investuar pas përfundimit të gjashtë muajve të parë ose nëse depoziti i afatizuar është vazhduar

edhe më tutje. Edhe pse teknikisht mundë të thuhet se interesi përlllogaritet në baza ditore, ai do të përfshihet në të ardhurat bruto kur të jetë paguar apo kredituar një shumë.

6. *Fitimi kapital. "Pranuar"* nënkupton se që nga shitja e pasurisë së paluajtshme ose të letrave me vlerë ka rezultuar fitimi dhe pagesa është pranuar gjatë periudhës tatimore. Për ata që i nënshtrohen tatimit të paragjykuar, metoda e kontabilitetit do të jetë ajo me para të gatshme në mënyrë që ardhurat do të raportohen në periudhën tatimore kur janë pranuar parat. Për ata që i nënshtrohen tatimit në të ardhurat reale metoda e kontabilitetit do të jetë ajo akruale. Për këtë kategori "Akruale" nënkupton se të ardhurat që raportohen në periudhën tatimore në të cilën janë pranuar paratë, është lëshuar fatura ose kur janë të predispozuara pasuritë e paluajtshme ose letrat me vlerë, cilado që ndodh e para.

7. *Fitimet nga Lotaritë dhe lojërat e fatit.* Të ardhurat nga këto fitore raportohen në periudhën tatimore në të cilën janë pranuar ose janë kredituar në llogarinë e fituesit.

Neni 4 Të Ardhurat e Liruara

1. Paragrafi 1.2 i nenit 7 të Ligjit parasheh se "*Të ardhurat e Bankës Qendrore të Kosovës dhe të institucioneve financiare qeveritare ndërkombëtare të lejuara dhe të autorizuar për të vepruar në Kosovë*" duhet të jenë të liruara nga tatimi në të ardhurat në korporata. Për qëllim të këtij paragrafi institucionet financiare qeveritare ndërkombëtare përfshijnë:

- 1.1. Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN);
 - 1.2. Bankën Botërore- Bankën Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) dhe Asociacionin Ndërkombëtar për Zhvillim (IDA);
 - 1.3. Korporatën Ndërkombëtare për Financim (IFC) dhe anëtarët tjerë të Grupit të Bankës Botërore;
 - 1.4. Komisionin Evropian(EC);
 - 1.5. Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim(EBRD);
 - 1.6. Bankën Evropiane për Investim (EIB);
 - 1.7. Bankën Ndër-amerikane për Zhvillim(IADB);

 - 1.8. Bankën Aziatike për Zhvillim (ADB)
 - 1.9. Bankën Afrikane për Zhvillim (AFDB);
 - 1.10. Fondin Ndërkombëtar për Zhvillim të Bujqësisë (IFAD)
 - 1.11. Bankën Islamike për Zhvillim (IDB)
2. Për qëllime të paragrafëve 1.6 dhe 1.7 të Nenit 7 të Ligjit, shprehja "ndryshe nga personi vendor" nënkupton kontraktuesit e vendosur jashtë Kosovës të cilët nuk janë të obliguar që të regjistrohen në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë në Kosovë por të cilët janë të obliguar që të njoftojnë ATK-n në formë të shkruar se janë duke punuar në Kosovë.
- 2.1. Nëse kontraktuesi jo-vendor zhvillon aktivitetet të tjera në Kosovë,që janë të ndryshme nga këto në relacion me organizatat e përmendura në këta paragrafë, duhet të regjistrohet në Kosovë në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë dhe në ATK(në këtë të fundit qoftë duke aplikuar për numrin fiskal ose duke caktuar përfaqësuesin fiskal i cili do të jetë i detyruar për të gjitha

tatimet e kontraktorit në Kosovë), dhe të ardhurat e krijuara nga këto aktivitetet tjera përfshihen në të ardhurat bruto të tatimpaguesit.

2.2. Këta kontraktues jo-vendor pavarësisht se a kanë ndonjë aktivitet tjetër apo jo, gjithashtu janë përgjegjës (qoftë në mënyrë direkte ose nëpërmes të përfaqësuesit të tyre fiskal) për përmbushjen e çdo obligimi të mbajtjes së tatimit në burim të aplikueshëm të paraparë në Kapitullin VII të Ligjit

3. Për qëllime të paragrafit 1.7 të Nenit 7 të Ligjit shprehja “organizatat ndërkombëtare ndër-qeveritare” duhet të përfshijë:

3.1. Korporatën Ndërkombëtare të Financave (IFC) dhe anëtarët tjerë të Grupit të Bankës Botërore,

3.2. Bankën Ndër-Amerikane për Zhvillim(IADB)

3.3. Bankën Aziatike për Zhvillim (ADB),

3.4. Bankën Afrikane për Zhvillim (AFDB)

3.5. Bankën Islamike për Zhvillim (IDB).

Neni 5

Shpenzimet e Lejueshme

1. Paragrafi 5 i nenit 9 të Ligjit parasheh që nuk lejohen zbritje për çdo shpenzim të përlllogaritur lidhur me të ardhurat të cilat i nënshtrohen tatimit në burim përveç nëse janë paguar shpenzimet më ose para 31 Marsit të vitit vijues.

Shembull:

Kompania e një biznesi që ka qarkullim më të lartë se 50,000 euro (dhe llogarit për tatim në të ardhura në baza “reale” jep me qira lokalet e saj. Në fund të vitit 2010,ja ka borxh qiradhënësit 3000 euro për 3 muaj të qirasë deri më 31 dhjetor 2010. Biznesi kërkon këtë shpenzim të qirasë në baza aktuale. Nëse qiraja e përlllogaritur paguhet më ose para 31 marsit 2011,zbritja e shpenzimeve të qirasë e kërkuar në periudhën tatimore 2010 për tre muajt e fundit, do të lejohet.

Mirëpo nëse kjo qira nuk paguhet deri më 31 Mars 2011, atëherë kompania nuk do të jetë në gjendje që të kërkojë qiranë e përlllogaritur në periudhën tatimore 2010. Kjo qira mund të kërkohet si shpenzim në periudhën tatimore (2011 ose më vonë) kur është paguar borxhi i qirasë.

Neni 6

Tatimi i Mbajtur në Burim në Interes dhe të Drejtat Pronësore (Royalties)

1. Paragrafi 1 i nenit 30 i Ligjit kërkon nga tatimpaguesit që të mbajnë tatimin në burim në pagesat e interesi dhe të drejtave pronësore. Interesi apo të drejtat pronësore të paguara apo të kredituara personit i cili është i liruar nga Tatimi në të Ardhurat në Korporata sipas nenit 7 të Ligjit dhe sipas çdo ligji tjetër të Kosovës, ose sipas një marrëveshje ose konvente ndërkombëtare, nuk duhet ti nënshtrohen tatimit në burim. Në këto raste barra bie në pranuesin e interesit dhe të drejtave pronësore që ti sigurojë evidencë me shkrim pagesit se të ardhurat e tij janë të liruara nga Tatimi në të Ardhurat në Korporata. Derisa të krijohet një evidencë e këtillë obligimi i mbetet pagesit që të mbaj në burim.

2. Evidenca në formë të shkruar e kërkuar në paragrafin 2 të këtij Neni duhet të jetë:
 - 2.1 në rast se organizata është e liruara nga Tatimi në të Ardhurat në Korporata sipas paragrafit 1.1 të nenit 7 të Ligjit, një kopje e certifikatës së regjistrimit të organizatës jo-qeveritare;
 - 2.2 në rast të organizatave të liruara nga Tatimi në të Ardhurat në Korporata sipas paragrafit 1.7 ose 1.8 të nenit 7 të Ligjit, një kopje e kontratës së tyre,
 - 2.3 në rast të institucioneve financiare qeveritare ndërkombëtare të cilat nuk janë përmendur në mënyrë të veçantë në paragrafin 1 të nenit 2 të këtij Udhëzimi Administrativ, një kopje e letrës e cila autorizon veprimtarin e tyre në Kosovë,
 - 2.4 në rast të organizatave të huaja qeveritare dhe diplomatike, një kopje e letrës e cila autorizon punën e tyre në Kosovë;
 - 2.5 në çdo rast, tjetër nga rasti i autoriteteve publike (ku nuk ka nevojë për evidencë me shkrim) një kopje e letrës nga ATK e cila konfirmon lirimin nga Tatimi në të Ardhurat në Korporata.
3. Paragrafi 4 i nenit 30 të Ligjit parasheh që interesi në kreditë e dhëna nga institucionet e licencuara nga BQK për klientët e tyre në kursin e zakonshëm të biznesit të tyre nuk do të nënshtrohen tatimit në burim.

Shembull:

Banka A e Kosovës i jep kredi Biznesit B të Kosovës si pjesë e biznesit normal komercial të huadhënies. Meqë kredia është dhënë në kursin e zakonshëm të biznesit të Bankës A, Biznesi B nuk është i detyruar të mbaj tatimin në burim në komponentin e interesit të ri-pagesës së kredisë.

4. Lirimi nga mbajtja e tatimit në burim i paraparë në paragrafin 3 të këtij neni aplikohet vetëm për interesin e kredive të dhëna nga institucionet financiare të licencuara nga BQK. Kjo nuk aplikohet për interesin e paguar në kredi nga institucionet financiare jo-rezidente-në këto raste paguesi i interesit është i detyruar që të mbaj tatimin në burim nga pagesat e tyre të interesit për institucionet financiare jo-rezidente.

5. Për qëllim të pagesës së tatimit të mbajtur në burim ose interesit dhe/ose të drejtave pronësore sipas këtij Neni, mbajtësit në burim duhet të plotësojnë formularin e tatimit të mbajtur në burim dhe të pasqyrës së pagesës sikur që është përshkruar nga ATK dhe duhet të dorëzojë formularin dhe pagesën në një bankë ose institucion financiar të licencuar nga Banka Qendrore e Kosovës.

Neni 7 Tatimi i Mbajtur në Burim në Qira

1. Paragrafi 2 i nenit 30 të Ligjit kërkon që tatimpaguesit të mbajnë tatimin në burim në pagesat e qirasë. Qiraja e paguar ose e kredituar për personin i cili është i liruar nga

Tatimi në të Ardhurat e Korporatave sipas nenit 7 të Ligjit, sipas çdo ligji tjetër në Kosovë ose sipas një marrëveshje ose konvente ndërkombëtare nuk duhet ti nënshtrohet tatimit në burim. Në këto raste barra bie mbi pranuesin e qirasë që të sigurojë evidencë me shkrim për paguesin se të ardhurat e tyre janë të liruara nga Tatimi në të Ardhurat e Korporatave. Derisa të sigurohet kjo evidencë, obligimi mbetet te paguesi që të mbajë Tatimin në Burim.

2. Evidenca me shkrim e kërkuar sipas paragrafit 2 të këtij Neni duhet të jetë:

2.1 në rast të organizatave të liruara nga tatimi në të ardhurat e korporatave sipas paragrafit 1.1 të nenit 7 të Ligjit, një kopje e certifikatës së regjistrimit të organizatës jo qeveritare;

2.2 në rastin e organizatave të liruara nga tatimi në të ardhurat në korporata sipas paragrafit 1.7 ose 1.8 të nenit 7 të Ligjit, një kopje e kontratës së tyre;

2.3 në rast të institucioneve financiare qeveritare ndërkombëtare të cilat nuk janë përmendur në mënyrë specifike në paragrafin 1 të nenit 4 të këtij Udhëzimi Administrativ, një kopje e letrës e cila e autorizon operimin e tyre në Kosovë;

2.4 në rast të organizatave të huaja qeveritare dhe diplomatike një kopje e letrës e cila autorizon veprimtarin e tyre në Kosovë;

2.5 për çdo rast tjetër nga rasti i autoriteteve publike (ku nuk ka nevojë për evidencë me shkrim) një kopje e letrës nga ATK që konfirmon lirin nga tatimi në të ardhurat e korporatave.

3. Për qëllim të pagesës së tatimit të mbajtur në burim sipas këtij Neni, mbajtësit në burim duhet të plotësojnë formularin e mbajtjes së tatimit të burim dhe të pasqyrës së pagesës sikurse përcaktohet nga ATK dhe duhet të dorëzojnë formularin e pagesës në një bankë ose institucion financiar të licencuar nga Banka Qendrore e Kosovës.

4. Kërkesat për të mbajtur në burim tatimin në qira aplikohet vetëm për "tatimpaguesit" të cilët paguajnë qira. Tatimpaguesit janë definuar në nenin 3 të këtij Ligji, mirëpo ky nuk i mbulon institucionet qeveritare të huaja apo të Kosovës, duke përfshirë komunat. Këto organizata nuk janë të obliguara që të mbajnë tatimin në burim në pagesat e qirasë që i bëjnë mirëpo janë të detyruar të njoftojnë ATK-n në formë të shkruar se kujt i kanë paguar këtë pagesë të qirasë dhe shumën e këtyre pagesave.

Neni 8

Mbajtja e Tatimit në Burim në Fitimet e Lotarisë dhe Lojërave të Fatit

[Notë: Ky nen i Udhëzimit Administrativ do të del nga përdorimi kur të hyj në fuqi Ligji i ri për Lojërat e Fatit dhe Lotarinë, në përputhshmëri me paragrafin 1 të Nenit 38 të këtij Ligji]

1. Paragrafi 3 i nenit 30 i Ligjit kërkon që tatimpaguesit të mbajnë tatimin në burim në pagesat e lotarive dhe lojërave të fatit.. Lotaria, ose lojërat e fatit, fitimet e paguara apo kredituara për personin i cili është i liruar nga Tatimi në të Ardhurat në Korporata sipas Nenit 7 të Ligjit, sipas çdo ligji tjetër të Kosovës ose sipas një marrëveshje apo konvente ndërkombëtare, nuk i nënshtrohet mbajtjes së tatimit në burim. Në këto raste barra bie mbi pranuesin e fitimeve që të sigurojë evidencë me

shkrim për paguesin se të ardhurat e tyre janë të liruara nga Tatimi në të Ardhurat e Korporatave. Derisa të sigurohet kjo evidencë, obligimi bie në paguesin që të mbaj tatimin në burim.

2. Evidenca me shkrim që kërkohet sipas paragrafit 2 të këtij Neni duhet të jetë:

2.1 në rastin e organizatave të liruara nga tatimi në të ardhurat e korporatave sipas paragrafit 1.1 të Nenit 7 të Ligjit, një kopje e certifikatës së regjistrimit të organizatës jo-qeveritare;

2.2 në rastin e organizatave të liruara nga tatimi në të ardhurat në korporata sipas paragrafit 1.7 ose 1.8 të nenit 7 të Ligjit, një kopje e kontratës së tyre

2.3 në rastin e institucioneve financiare qeveritare ndërkombëtare të cilat nuk janë përmendur në mënyrë të veçantë në paragrafin 1 të nenit 4 të këtij Udhëzimi Administrativ, një kopje e letrës e cila autorizon veprimtarinë e tyre në Kosovë,

2.4 në rast të organizatave të huaja dhe diplomatike, një kopje e letrës e cila autorizon veprimtarinë e tyre në Kosovë;

2.5 në të gjitha rastet tjera nga rasti i autoriteteve publike (ku nuk ka nevojë për evidencë me shkrim), një kopje e letrës nga ATK që konfirmon lirimin nga Tatimi në të Ardhurat në korporata.

3. Për qëllime të pagesës së tatimit të mbajtur në burim për lotari ose në lojërat e fatit, fitimet sipas këtij neni, mbajtësit në burim duhet të plotësojnë formularin e mbajtjes në burim dhe pasqyrën e pagesës sikurse caktohet nga ATK dhe duhet të dorëzojnë formularin dhe pagesën në një bankë ose institucion financiar të licencuar nga Banka Qendrore e Kosovës.

Neni 9

Mbajtja e Tatimit në Burim për Disa Jo-rezidentë

1. Paragrafët 1 dhe 2 të nenit 31 të Ligjit kërkojnë mbajtjen e tatimit në burim nga të ardhurat e atribueshme për artistët jo rezident dhe për jo rezidentët që kryejnë shërbime në Kosovë. Kur këto të ardhura i paguhen apo kreditohen personit jo-rezidentë ose entitetit të cilët janë të liruara nga tatimi në të ardhurat në korporata sipas nenit 7 të Ligjit, sipas çdo Ligji tjetër të Kosovës ose sipas një marrëveshje apo konvente ndërkombëtare, këto të ardhura nuk duhet ti nënshtrohen mbajtjes së tatimit në burim. Në këto raste barra bie mbi pranuesin e të ardhurave që të siguroje një evidencë me shkrim për paguesin se të ardhurat e tija janë të liruara nga Tatimi në të Ardhurat në Korporata. Deri në sigurimin e kësaj evidence, obligimi mbetet te paguesi që të mbajë tatimin në burim.

2. Evidenca me shkrim e kërkuar sipas paragrafit 1 të këtij neni duhet të jetë:

2.1 në rast të organizatave të liruara nga tatimi në të ardhurat në korporata sipas paragrafit 1.1 të nenit 7 të Ligjit, një kopje e certifikatës së regjistrimit të organizatës jo-qeveritare;

2.2 në rastin e organizatave të liruara nga tatimi në të ardhurat në korporata sipas paragrafit 1.7 ose 1.8 të nenit 7 të Ligjit, një kopje e kontratës së tyre;

2.3 në rast të institucioneve financiare qeveritare ndërkombëtare që nuk janë përmendur në mënyrë të veçantë në paragrafin 1 të nenit 4 të këtij Udhëzimi Administrativ, një kopje e letrës e cila e autorizon veprimtarinë e tyre në Kosovë;

2.4 në rast të organizatave të huaja dhe diplomatike, një kopje e letrës që autorizon veprimtarinë e tyre në Kosovë;

2.5 në çdo rast tjetër,, një kopje e letrës nga ATK që konfirmon lirimin nga tatimi në të ardhurat e korporatave.

3. Kërkesa për të mbajtur tatimin në burim nga zbatimësit jo rezident sipas këtij neni aplikohet për të ardhurat e paguara nga çdo person për disa jo-rezident .Ndryshe nga dispozitat e mbajtjes së tatimit në burim të cilat aplikohen për interes,të drejta pronësore dhe qira,ku kërkesa për të mbajtur tatimin në burim kufizohet në “tatimpagues sipas Ligjit,obligimi për të mbajtur tatimin në burim sipas këtij neni gjithashtu aplikohet për personat tjerë si autoritetet publike.

4. Kërkesa për të mbajtur në burim nga të ardhurat e atribueshme për zbatimësit jo rezident sipas paragrafit 1 të nenit 31 të Ligjit ka të bëjë me aktivitetet personale të zbatimësit që ushtrohen në Kosovë. Pagesat për artistët jo rezident që nuk janë në lidhje me aktivitetet e tyre personale (p.sh nga shitjet e mallrave) nuk i nënshtrohen tatimit të mbajtur në burim. Pagesat nga Kosova për aktivitetet personale të ushtruara jashtë Kosovës gjithashtu nuk i nënshtrohen tatimit në burim.

5. Kërkesat për të mbajtur tatimin në burim nga të ardhurat e atribueshme për jo-rezidentë sipas paragrafit 1 të nenit 31 të Ligjit lidhet me të ardhurat që i atribuohen (qoftë të paguara me kesh apo në natyrë, të cilat më vonë do të vlerësohen me vlerën e hapur të tregut) zbatimësit qoftë të paguara direkt apo në mënyrë indirekte. Mbajtja në burim gjithashtu kërkohet kur zbatimësi paguhet në mënyrë indirekte, për shembull kur pagesa i është bërë Korporatës ose ndonjë personi tjetër juridik e cila është mbajtur 100% nga zbatimësi ose të cilat janë zotëruar nëpërmes të përfituesve të ndryshëm, e jo direkt te zbatimësi.

6. Të ardhurat e atribueshme për zbatimësin jo rezident sipas paragrafit 1 të Nenit 31 të Ligjit të cilat janë paguar ose kredituar në çdo rast tjetër nga ato të mbuluara në paragrafin 1 të këtij neni, do t'i nënshtrohen tatimit në burim përveç nëse kompensimi bruto i paguar ose kredituar për zbatimësin jo rezident lidhur me aktivitetet e tyre personale nga të gjithë paguesit për këto aktivitete nuk do të tejkalon vlerën prej 1000 euro në periudhën tatimore (në pajtueshmëri me paragrafin 1 të nenit 41 të Ligjit Nr. 03/L-161 “Për Tatimin në të Ardhurat Personale”). Në situatat kur paguesi nuk është i sigurt se nëse kompensimi bruto i artistit nga aktivitetet personale të atij apo asaj në periudhën tatimore do të tejkalojnë vlerën prej 1000 eurove, paguesi është i obliguar që të pyes artistin lidhur me kompensimin e asaj apo atij bruto të pritur,dhe vetëm nëse artisti tregon se kompensimi i tij bruto nga aktivitetet personale në periudhën tatimore do të jetë 1000 euro ose më pak pagesat ose kreditimi nuk do të nënshtrohet tatimit të mbajtur në burim.

7. Kërkesa për të mbajtur tatimin në burim nga të ardhurat e paguara për jo rezidentët sipas paragrafit 2 të nenit 31 të Ligjit lidhet me pagesat për shërbimet e kryera në Kosovë. Nga pagesat e bëra për jo-rezidentët për mallrat ose nga pagesat e bëra për jo rezidentët për shërbimet e kryera jashtë Kosovës nuk kërkohet mbajtja e tatimit në burim (p.sh shërbimet e transportit ndërkombëtar, mbështetja e sistemit kompjuterik e

siguruar nga distanca nga një shtet tjetër). Nevojitet një shpërndarje kur shërbimet kryhen edhe nga brenda edhe nga jashtë Kosovës, me përjashtim të rasteve kur shërbimet e kryera në një shtet janë shumë të vogla për shërbimet e bëra në shtetin tjetër.

Shembull:

Biznesi i Kosovës hyn në kontratë me furnizuesin jo-rezident për të dizajnuar softuerin kompjuterik për shfrytëzim nga biznesi i Kosovës. E gjithë puna e dizajnit dhe testimit kryhet jashtë Kosovës. Mirëpo përfaqësuesi i furnizuesit kërkohet që të vizitojë Kosovën për tu siguruar se softueri është instaluar si duhet. Në këto rrethana vizita e instalimit do të konsiderohet si pjesë shumë e vogël në krahasim me punën kryesore të dizajnit të softuerit, dhe meqë kjo është kryer jashtë Kosovës, nuk do të aplikohet mbajtja e tatimit në burim për pagesat për furnizuesit jo-rezident. Për dallim nga kjo nëse furnizuesi më pas ka hyrë në kontratë për mirëmbajtje për softuer e cila ka paraparë disa testime të sistemit jashtë Kosovës, mirëpo gjithashtu disa vizita në vend në Kosovë, atëherë do të aplikohet mbajtja e tatimit në burim për shpenzimet e kontratës së mirëmbajtjes lidhur me atë pjesë të shpenzimeve që lidhen me punën e vizitës në vend të punës të kryera në Kosovë.

8. Kërkesa për të mbajtur tatimin në burim sipas paragrafit 2 të nenit 31 të Ligjit aplikohen vetëm për ata të cilët konsiderohen si jo-rezidentë për qëllime të tatimit në të ardhura e korporatave dhe të cilët nuk kanë njësi të përhershme në Kosovë. Paragrafi 4 i nenit 31 të Ligjit parasheh që në këto raste “*mbajtja e tatimit në burim sipas këtij neni do të konsiderohet si tatim final dhe pranuesit e këtyre të ardhurave që i nënshtrohen mbajtjes së tatimit në burim nuk do të dorëzojnë deklaratë në administratën tatimore pavarësisht nga dispozitat e nenit 34 të këtij Ligji*” Tatimi i mbajtur në burim prej 5% do të jetë detyrimi i fundit tatimor për të ardhurat në korporata në Kosovë dhe këta nuk janë të lejuar që të dorëzojnë deklaratë tatimore vjetore për tatimin në të ardhurat në korporata për të kërkuar mbajtjet në burim duke u bazuar në atë se nuk janë obligues për tatim në të ardhurat e korporatave në Kosovë sepse nuk kanë njësi të përhershme këtu.

9. Për qëllim të pagesës së tatimit të mbajtur në burim në të ardhurat e llojeve të referuara në paragrafët 1 dhe 2 të Nenit 31 të Ligjit, pagesit duhet të plotësojnë formularin e tatimit të mbajtur në burim dhe pasqyrës së pagesës sikurse caktohet nga ATK, dhe formulari dhe pagesa duhet të dorëzohen në një bankë ose institucion financiar të licencuar nga Banka Qendrore e Kosovës.

10. Për qëllime të këtij Neni, termi “pagesë” nënkupton çdo person ose entitet, qoftë një organizatë ose individ i cili është pajtuar që të paguaj personin jo-rezident ose entitetin për zbatimje ose shërbime tjera të kryera në Kosovë.

Neni 10

Dispozitat e Përgjithshme që Aplikohen për Tatimet e Mbajtura në Burim

1. Kapitulli VII i Ligjit parasheh që tatimet e mbajtura në burim do të zbriten nga llojet e ndryshme të pagesave për “personat” pavarësisht nëse sipas Ligjit këta persona janë “tatimpagues” apo jo. Megjithëse ky Udhëzim Administrativ parasheh, që mbajtjet e tatimit në burim nuk duhet të zbatohen për personat të cilët janë tatimpagues të cilët janë të liruar nga tatimi në të ardhurat në korporata, ato aplikohen për personat të cilët nuk janë tatimpagues.

Shembull:

1. Kompania jo rezidente që nuk ka njësi të përhershme në Kosovë për qëllime të Ligjit mbi Tatimin në të Ardhurat e Korporatave të Kosovës nuk është “Tatimpagues”. Interesi i paguar kësaj kompanie nga banka e Kosovës do të nënshtrohet tatimit në burim. Edhe pse kompania nuk është obliguese për tatim në të ardhurat e korporatave në Kosovë, nuk mundë të dorëzojë deklaratë për tatimin në të ardhurat e korporatave në Kosovë për të kërkuar mbajtjet në burim meqë nuk është “tatimpagues”

2. Kapitulli VII i Ligjit parasheh që tatimet e mbajtura në burim duhet të paguhen në një bankë ose institucion financiar të licencuar nga Banka Qendrore e Kosovës. Këto pagesa mundë të dorëzohen në çdo filial të një banke apo institucioni financiar të autorizuar që i pranon ato. Me përjashtim të rasteve kur nga Drejtori i Përgjithshëm i ATK-s caktohen zyrtarët tatimor të caktuar për të mbledhur tatimin sipas Ligjit Mbi Administratën Tatimore dhe procedurat këto pagesa nuk duhet të dorëzohen në çdo zyrë apo te çdo zyrtarë i ATK-s.

3. Pagesat e referuara në paragrafin 2 të këtij neni duhet të shoqërohen me një pasqyrë mbi tatimin e mbajtur në burim. Pasqyra e tatimit të mbajtur në burim do të jetë:

3.1 për ata mbajtës të tatimit në burim të cilët dëshirojnë dhe janë në gjendje që të deklarojnë në mënyrë elektronike në ATK informatat e tyre mbi tatimin e mbajtur në burim, një dëftesë e pagesës së tatimit të mbajtur në burim.

3.2 për mbajtësit tjerë të tatimit në burim, një formular i pasqyrës së tatimit të mbajtur në burim dhe pagesës siç do të përshkruhet nga ATK.

4. Kapitulli VII i Ligjit parasheh që pasqyrat vjetore të barazimit, së bashku me kopjet e certifikatave të tatimit të mbajtur në burim kërkohen që ti sigurohen Administratës tatimore. Këto pasqyra dhe certifikata mundë të sigurohen në çdo zyrë të Administratës tatimore të Kosovës ose në çdo filial të një banke apo institucioni financiar të autorizuar që i pranon ato.

5. Kapitulli VII i Ligjit parasheh datat specifike në të cilat duhet të bëhet pagesa e tatimit të mbajtur në burim, certifikatat e tatimit të mbajtur në burim duhet të sigurohen për pranuesit, dhe mbajtësit e tatimit në burim kërkohet që të sigurojnë pasqyrën vjetore të barazimit për Administratën tatimore. Në çdo rast ku data specifike e deklarimit apo pagesës është e shtunë, e Diele apo Festë Kombëtare, këto forma dhe/ose pagesa duhet të dorëzohen më së voni në ditën e parë të punës që pason pas së shtunës, dielës apo Festës Kombëtare. Interesi dhe ndëshkimet për deklarim apo pagesë me vonesë nuk do të aplikohen kur deklarimi dhe/ose pagesa ndodhin para ose më ditën pasuese të punës.

6. Kapitulli VII i Ligjit parasheh kërkesa të ndryshme të deklarimit dhe pagesave për mbajtësit në burim dhe pagesit. Kur këto kërkesa nuk plotësohen, ATK do të zbatojë

interesin dhe ndëshkimet administrative sipas Ligjit mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat për, si të aplikueshme :

- 6.1 dështimin e mbajtjes në burim, mbledhjes ose pagesës së tatimit të mbajtur në burim,
- 6.2 dështimin për të siguruar pranuesin e të ardhurave që i nënshtrohen mbajtjes së tatimit në burim me certifikatën e mbajtjes së tatimit në burim,
- 6.3 dështimin për të deklaruar pasqyrën vjetore të barazimit në ATK në afatin e caktuar,
- 6.4 deklarin jo të saktë dhe jo të plotë të pasqyrës vjetore të barazimit në ATK.

7. Ndëshkimi për mos mbajtjen e Tatimit në Burim sipas Ligjit mbi Administratën tatimore dhe Procedurat , do të aplikohet për personin i cili ka qenë i detyruar të mbaj në burim nga data e duhur, në mënyrë që Tatimi i Mbajtur në Burim të paguhet në atë datë kur detyrimi vjetor mbi tatimin në të ardhurat në korporata i pranuesit është paguar, ose është finalizuar në një mënyrë tjetër.

Neni 11

Pagesat Tremujore të Paradhënieve

1. Në përputhje me paragrafin 2.1 të Nenit 35 të Ligjit, tatimpaguesit me të ardhura vjetore bruto prej 50,000 euro ose më pak dhe ata që nuk zgjedhin të përgatisin pasqyrat financiare janë të obliguar për të bërë pagesat tremujore të paradhënieve për tatimin mbi të ardhurat e korporatave. Këta Tatimpagues do të dorëzojnë pasqyrat Tremujore të pagesave të avancit për Korporatat e vogla në formatin e përshkruar nga ATK, në çdo bankë apo institucion financiar të autorizuar në ose përpara 15 prillit, 15 korrikut, 15 tetorit dhe 15 janarit në lidhje me tremujorët kalendarik që menjëherë i paraprijnë këtyre datave. Në mënyrë alternative, kur tatimpaguesit deklarojnë në ATK në mënyrë elektronike pasqyrat e tyre mbi pagesat tremujore të avancit për Korporatat e vogla ,pagesat në një bankë apo institucion financiar të autorizuar duhet të shoqërohen me një dëftesë mbi pagesën tremujore të avancit.

2. Në përputhje me paragrafin 2.2 të Nenit 35 të Ligjit, tatimpaguesit me të ardhura vjetore bruto që tejkalon 50,000 euro dhe ata që zgjedhin të përgatisin pasqyrat financiare janë të obliguar për të bërë pagesat tremujore të avancit për tatimin mbi të ardhurat e korporatave. Këta Tatimpagues dhe kompanitë e sigurimit, duhet të dorëzojnë Pasqyra Tremujore të pagesës së Avancit për Korporatat e mëdha në formatin e përshkruar nga ATK, në çdo bankë apo institucion financiar të autorizuar në ose përpara 15 prillit, 15 korrikut, 15 tetorit dhe 15 janarit për tremujorët kalendarik që menjëherë i paraprijnë këto data. Në mënyrë alternative, kur tatimpaguesit deklarojnë në ATK në mënyrë elektronike pasqyrat e tyre mbi pagesat tremujore të avancit për Korporatat e mëdha ,pagesat në një bankë apo institucion financiar të autorizuar duhet të shoqërohen me një dëftesë mbi pagesën tremujore të avancit.

3. Tatimpaguesit e mbuluar nga paragrafi 2.2 i nenit 35 të ligjit janë të detyruar të përdorin bazat e parashikimit në vitin e tyre të parë të bërjes së pagesave tremujore të avancit dhe parashikimet janë të bazuara në $\frac{1}{4}$ e detyrimit tatimor vjetor të parashikuar për vitin e parë. Për ata që fillojnë si tatimpagues gjatë tremujorit të parë

kjo nuk është problem, por për ata të cilët fillojnë më vonë gjatë vitit, ata kërkohet të paguajnë vetëm $\frac{3}{4}$, $\frac{1}{2}$ ose vetëm $\frac{1}{4}$ e detyrimit të tyre të vitit të parë në këste gjatë vitit të parë. Për vitin e tyre të dytë, duke bërë pagesa tremujore të avancit bazuar në detyrimin tatimor vjetor për aktivitetin e tyre ekonomik për vitin e parë të tyre, e rritur për 10%, do të thotë se nuk paguhet ndonjë ndëshkim interesi. Tatimpaguesit, pagesat e paradhënies të të cilëve janë të pamjaftueshme krahasuar me detyrimin tatimor final do të ndëshkohen vetëm për tremujorin e fundit të vitit të parë, por bazuar në shumat kumulative të kësteve krahasuar me detyrimin vjetor, e jo duke e konsideruar këstin e fundit thjesht si të izoluar. Në këto raste interesi ndëshkimi do të aplikohet vetëm kur pagesat e bëra tremujore të avancit kanë qenë më të vogla se 90% të detyrimit tatimor vjetor për aktivitetin e tyre ekonomik për vitin e parë të tyre. Për vitin e dytë dhe vitet tjera vijuese meqë është në dispozicion opsioni i pagesës pa ndëshkime dhe interes ata do të ndëshkohen për çdo këst tremujor nëse janë bërë pagesa të pamjaftueshme gjatë vitit.

Shembulli 1:

Një tatimpagues korporatë ka filluar aktivitetin e tij në vitin 2010. Ai ka paguar në 3 këste (tremujorët 2, 3 dhe 4), respektivisht 100 €, 200 € dhe 620 €. Detyrimi vjetor për tatimin në të ardhurat e korporatave për vitin 2010 rezulton të jetë 1.000 €. Në këtë rast, meqë tërë këstet (920 euro), janë më shumë se 90% e detyrimit vjetor (90% e 1.000 = 900 euro) nuk aplikohet ndëshkimi në interes (sipas paragrafi 8,3 të nenit 35 të Ligjit).

Shembulli 2:

Një tatimpagues korporatë ka filluar aktivitetin e tij në vitin 2010. Ai ka paguar në 2 këste (tremujorët 3 dhe 4), respektivisht 200 € dhe 500 €. Detyrimi vjetor për tatim në të ardhurat e korporatave për vitin 2010 rezulton të jetë 1.000 €. Në këtë rast, meqë tërë këstet (700 euro) janë më pak se 90% e detyrimit vjetor (90% e 1.000 = €900) interesi paguhet duke filluar nga 15 janar 2011 (data e caktuar e këstit të tremujorit të fundit në lidhje me vitin tatimor 2010). Ky interes është i bazuar në 300 € diferencës në mes detyrimit vjetor (1.000 euro) dhe kësteve kumulative totale të paguara (700 euro) dhe llogaritet nga 15 janari 2011 deri në datën e afatit për dorëzimin e deklaratës finale (31 mars 2011). Në këtë kohë përfundojnë ndëshkimet, interesi për nën-pagesën e pagesave të paradhënies, mirëpo pastaj mundë të aplikohen ndëshkimet e rregullta lidhur me çdo periudhë ndërmjet kësaj date të afatit deri sa të paguhet tatimi.

4. Në rastet kur këstet e hershme kanë qenë shumë të ulëta dhe këstet e më vonshme kanë qenë shumë të larta, ndëshkimet do të aplikohen për këstet e hershme derisa pagesat e tepërta të mëvonshme të mbulojnë mungesat e hershme. Në rastet kur Këstet e hershëm kanë qenë shumë të larta dhe këstet e më vonshme kanë qenë shumë të ulëta, ATK do të pranoj tepricat e periudhave më të hershme që mbulojnë mungesat në periudhat e mëvonshme dhe interesi dhe ndëshkimet mund, ose mund të mos aplikohen, varësisht nga shumat e tepricave dhe mungesave.

Shembull:

Në vitin 2010 biznesi i tatimpaguesit ka bërë një fitim dhe 1.000 € tatim mbi të ardhurat e korporatave ka qenë për tu paguar. Për vitin 2011, një tjetër fitimi është bërë dhe 2.000 € tatimi mbi të ardhurat e korporatave ka qenë e pagueshme (në 2012). Gjatë viti 2011 këste tremujore janë përbërë prej 600 euro, 100 € nuk ka këst, dhe 350 € respektivisht. Duke pasur parasysh detyrimin vjetor në vitin 2010 prej 1.000 euro dhe duke shtuar 10%, këstet tremujore gjatë vitit 2011 duhet të kenë qenë të paktën 275 € secila. Nuk ka pasur ndëshkim dhe interes për tu paguar për këstin e parë (meqë pagesa prej 600 euro e ka tejkaluar 275 euro për t'u paguar). Nuk ka pasur ndëshkim dhe interes për tu paguar për këstin e dytë (meqë pagesa prej 100 € plus 325 euro (600 pa 275) që ka tepruar nga kësti i parë e ka tejkaluar 275 euro për t'u paguar). Interesi për tu paguar në këstin e tretë do të bazohet në 125 € (duke qenë 275 € për tu paguar pa 150 euro që kanë mbetur (dy pagesat që gjithsejtë bëjnë 700 euro pa detyrimi për këto dy këste prej 550 euro) që kanë mbetur tepriçë nga këstet e mëparshme). Nuk ka interes për tu paguar në këstin e katërt dhe tepriça prej 75 € (350 të paguara, krahasuar me 275 të pagueshme) mund të aplikohen për të ulur interesin për t'u paguar në këstin e tretë, por me efekt vetëm nga data e pagesës së këstit të katërt.

5. Nën-paragrafi 2.2.2 i nenit 35 të Ligjit i referohet pagesave të bazuara në detyrimin tatimor të vitit të kaluar. Në rastin kur tatimpaguesi ka humbje tatimore për një vit të caktuar, atëherë në vend që të përdoren bazat e detyrimit tatimor të vitit të kaluar dhe të aplikohet llogaritja prej 110%, tatimpaguesi është i detyruar të llogarisë dhe të paguajë këstet bazuar në të ardhurat e tatueshme të parashikuara për vitin aktual. Nëse tatimpaguesi vlerëson se ata do të bëjnë një humbje në vitin aktual, ose që çdo fitim do të tejkalohet nga humbjet e bartura përpara, këstet nuk do të jenë të nevojshme, por ndëshkim me interes mundë të aplikohet nëse rezulton që parashikimi i tatimpaguesit të jetë i pasaktë.

Shembull:

Në vitin 2010 biznesi i tatimpaguesit ka pasur humbje. Në vitin 2011, tatimpaguesit parashikon se biznesit do të ketë fitim (pas lejimit që humbjet të barten përpara) dhe detyrimi vjetor tatimor do të jetë 1.000 €. Këstet kërkohet që të paguhen gjatë vitit 2011 duke u bazuar në $\frac{1}{4}$ e detyrimit tatimor vjetor të parashikuara.

6. Në rastet kur ka pasur një kontroll tatimor ose ngjarje të tjera në vitin vijues që përcakton një detyrim tatimor vjetor të ndryshëm në lidhje me një vit tatimor të mëhershëm, nëse detyrimi vjetor tatimor është gjetur të jetë më i lartë, ndëshkimet do të aplikohen për nën-deklarim, për pagesa të vonuara dhe gjithashtu edhe interesi në lidhje me detyrimin vjetor të paguar më pak. Ndëshkimet e tilla dhe interesi për detyrimin tatimor shtesë të zbuluar më pas do të aplikohen vetëm për detyrimin vjetor tatimor, dhe nuk do të bëhet rregullim në shumën e kësteve tremujore të kaluara ku rezultati i kontrollit tatimor apo ngjarjeve të tjera ka qenë rritja e detyrimit tatimor deri në 20%. Në rastet kur ka pasur një rritje të detyrimit tatimor prej më shumë se 20%, atëherë dënimi me interes do të aplikohet deri në atë masë ku këstet tremujore kanë qenë nën $\frac{1}{4}$ e 110% të detyrimit tatimor të rregulluar në të ardhura si rezultat i kontrollit tatimor apo ngjarjeve të tjera.

7. Paragrafët paraprijës të këtij neni parashohin data specifike në të cilat kërkohet që të dorëzohen formularët e pagesave tremujore të avancit dhe në të cilat kërkohet që të


paguhen pagesat tremujore te avancave. Në secilin rast, kur data specifike e deklarimit/ose pagesës është e shtunë, e Diele ose Festë Shtetërore, këta formular dhe/ose pagesa duhet të dorëzohen më së voni në ditën e parë të punës pas së (shtunës) dielës ose Festës Kombëtare. Nuk do të aplikohen ndëshkimet dhe interesi për deklarim ose pagesë me vonesë kur deklarimi/ose pagesat ndodhin në ose më herët se dita e ardhshme e punës.

8. Formulari vjetor i tatimit në të ardhurat e korporatave është një deklaratë tatimore por pasqyrat tremujore te pagesave të paradhënies nuk konsiderohen të jenë deklaratat tatimore. Në përputhje me paragrafin 8 të nenit 35 të Ligjit, ndëshkimet për deklarimin e vonuar dhe për pagesën e vonuar nuk do të zbatohen për formularët e deklaruar me vonesë të kësteve tremujore, por interesi do të aplikohet, përveç kur zbatohen dispozitat e nën-paragrafëve 8,1, 8,2 ose 8,3 të këtij neni.

Neni 12 Hyrja Në Fuqi

Ky Udhëzim Administrativ, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Ministri i Ekonomisë dhe Financave.

Bedri HAMZA



Zv. Ministër

Datë 30 / 07 / 2010